



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

UDHËZUESI PËR APLIKANTËT E GRANTEVE
PZHRB 2024

Skema e Granteve “Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB)
2024”

Start – UP / Student;

Start – UP;

LOT I: Biznes ekzistues;

LOT II: Biznes ekzistues.

Autoriteti Kontraktues:
Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR)

Afati për dorëzimin e aplikacionit:
Nga 15.05.2024 deri më 05.06.2024 ora 16:00

Përmbajtja:

1. SKEMA E GRANTEVE “PROGRAMI PËR ZHVILLIM RAJONAL TËBALANCUAR”	3
1.1 Hyrje.....	3
1.2 Skema “Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar”	4
1.3 Synimet e Thirrjes për Propozime	4
1.4 Përkrhja financiare e ofruar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal	4
1.5 Shumat e granteve.....	5
2 RREGULLAT PËR THIRRJEN PËR PROPOZIME	6
2.1 Kualifikimi i aplikantëve: kush mund të aplikojë?	7
2.2 Aplikantët që nuk kualifikohen	7
2.3 Aplikantët që kualifikohen (sektorët)	7
2.4 Kohëzgjatja e projektit	8
2.5 Lokacioni i projektit	8
2.6 Kualifikueshmëria e shpenzimeve: kostot që mund të merren parasysh për grantin	8
2.6.1 Kostot e kualifikueshme	8
2.6.2 Kostot e pakualifikueshme janë:.....	9
2.7 Procedurat e Prokurimit	10
3 SI TË APLIKOHET DHE PROCEDURAT QË DUHET NDJEKUR	10
3.1 Mënyra e aplikimit	10
3.2 Ku dhe si të bëhet aplikimi.....	13
3.3 Informata të mëtutjeshme për aplikimin.....	14
3.4 Afati i fundit për aplikim	14
4 KRITERET E VLERËSIMIT	15
Lista rezervë mbyllet në përfundim të vitit fiskal 2024, pra nuk vlen në vitin 2025.....	15
5 ANKESAT	15

1. SKEMA E GRANTEVE “PROGRAMI PËR ZHVILLIM RAJONAL TËBALANCUAR”

1.1 Hyrje

Ministria e Zhvillimit Rajonal, bazuar në mandatin ligjor që ka, çdo vit zhvillon, implementon dhe menaxhon programe për zhvillim rajonal të balancuar, programe këto që rrisin zhvillimin socio – ekonomik të balancuar në Rajonet Zhvillimore të Kosovës, kanë impakt të drejtpërdrejt në zhvillimin e bizneseve mikro dhe të vogla, zgjerimin e kapaciteteve të tyre prodhuese apo shërbyese, gjenerimin e vendeve të reja të punës sidhe zvogëlimin e importit dhe nxitjen e eksportit.

Andaj, edhe këtë vit MZHR lanson Thirrjen ‘Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar’ (PZHRB 2024), me qëllim të përkrahjes së bizneseve start-UP si dhe atyre ekzistuese.

MZHR përmes këtij programi në koordinim me partnerët ndërkombëtar ka arritur që ndër vite të ndihmojë bizneset të zgjerojnë kapacitetet e tyre prodhuese dhe shërbyese duke arritur një qëndrueshmëri afatgjate të funksionimit të bizneseve, po ashtu ka ndikuar në rritjen e qarkullimit të bizneseve, zvogëlimin e importit si dhe nxitjen e eksportit. Po ashtu, janë realizuar trajnime për ngritjen e kapaciteteve të qëndrueshmërisë së bizneseve ekzistuese, në veçanti është punuar me kategorinë Start- UP në funksion të përkrahjes së tyre si biznese fillestare.

MZHR edhe këtë vit do të mbajë sesione informuese për aplikantët potencial/bizneset sa i përket aplikimit online përmes [eKosova \(shih piken 3.1 të këtij udhëzuesi\)](#) si dhe sesione informuese për aplikim, implementim të projekteve dhe gjithë çfarë ndërlihet me këtë Thirrje dhe interesimin e palëve, sesionet informuese organizohen nga MZHR në bashkëpunim me Komunat, Partnerët dhe AZHR-të në Rajonet Zhvillimore të cilat operojnë.

Në këtë kontekst, MZHR ka rritur përkushtimin rreth krijimit të mundësive të reja bashkë me donatorë vendor dhe ndërkombëtar për ngritjen e kapaciteteve për aplikim dhe implementim të projekteve në bashkëpunim me partnerët: BERZH, UNICEF, CARITAS-in Zviceran, projektet e financuara nga USAID por duke mos u kufizuar tek këta donatorë. Pra kjo thirrje mund të konsiderohet të jetë në partneritet paralel për programet me donatorë.

Ministria e Zhvillimit Rajonal përmes kësaj skeme mbetet e përkushtuar të mbështesë edhe më fuqishëm projektet e qëndrueshme të udhëhequra nga gratë, të fuqizoj gratë në të bërit biznes si dhe të rrisë kapacitet e tyre profesionale dhe menaxheriale për një qëndrueshmëri afatgjate të biznesit. Gjithashtu kjo skemë inkurajon aplikime me projekte inovative nga të rinjtë si dhe komunitetet jo shumicë.

Ministria e Zhvillimit Rajonal në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar ka mbështetur dhe vazhdon të mbështesë edhe përmes kësaj thirrje prodhimin dhe shërbimet. Në vijim, janë të përshkruara të gjitha kriteret e aplikimit dhe udhëzimet për aplikantët potencial.

1.2 Skema “Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar”

Ministria e Zhvillimit Rajonal me lansimin e grant skemës për financimin e sektorit privat, u ndihmon atyre që të plotësojnë nevojat e tyre të të bërit biznes.

Synimi kryesor i skemës së granteve për sektorin privat është që të mundësojë që projektet cilësore afariste të implementohen dhe zhvillohen më tej deri në rritjen e kapaciteteve të tyre në të gjitha segmentet duke përfshirë edhe krijimin e vendeve të reja të punës të cilat do të gjenerohen nga rritja e ndërmarrjeve ekzistuese si dhe krijimi i ndërmarrjeve të reja.

1.3 Synimet e Thirrjes për Propozime

Synimi i përgjithshëm i kësaj thirrjeje për propozime është zhvillimi socio-ekonomik rajonal i balancuar përmes zhvillimit të ndërmarrësisë në Rajonet Zhvillimore të Kosovës.

Synimet specifike të kësaj thirrjeje për propozime janë:

1. Përkrahja e bizneseve të reja dhe zhvillimi i bizneseve me potencial rritjeje;
2. Përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve;
3. Përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në rritjen e eksportit;
4. Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për të rinjtë.

1.4 Përkrahja financiare e ofruar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal

Shuma e përafërt e kësaj thirrjeje është rreth 1,300,000.00€ (një milion e treqind mijë euro) por Ministria e Zhvillimit Rajonal rezervon të drejtën që të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Po ashtu, në rast se Qeveria e Republikës së Kosovës ndanë mjete shtesë për MZHR-në në kategorinë grante dhe subvencione, në cilën do periudhë kohore pas publikimit të thirrjes, atëherë shpërndarja e atyre mjeteve do të bëhet për aplikuesit që janë në listë të pritjes/rezervë nga thirrja PZHRB 2024, deri në shpenzimin e mjeteve të ndara.

Ministria e Zhvillimit Rajonal shumën prej rreth 1,300,000.00€ (një milion e treqind mijë euro), do ta ndajë për të tri kategoritë në mënyrë të balancuar për Rajonet Zhvillimore.

Rajonet Zhvillimore bazuar në ligjin për Zhvillim Rajonal me Nr. 08/L-190, konkretisht në Nenin 16, ndarja është shtatë (7) rajone zhvillimore, kurse ndarja e mjeteve do të bëhet bazuar në Nenin 5 të të njëjtit ligj, si dhe në metodologjinë e përshkruar në Nenin 19 të Rregullores për Menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, Rregullore e cila është dërguar për miratim në Qeveri, formulë që përcaktohet përmes indikatorëve (të pranuar nga ASK - Agjencioni i Statistikave të Kosovës).

1. Në kategorinë Start-UP (Studentë) kanë të drejtë aplikimi studentët e vitit të fundit të studimeve nga Universitetet që kanë Marrëveshje bashkëpunimi me MZHR. Projekt propozimet e studentëve duhet të jenë në tersi ose të ndërlidhura ekskluzivisht me fushën e studimeve.
2. Në kategorinë Start-UP kanë të drejtë aplikimi individët që kanë synim për të regjistruar biznes. Aplikimi mund të bëhet për sektorët dhe veprimtaritë pa përjashtim (përveç tregtia, ndërtimtaria, bujqësia, shëndetësia dhe arsimit);

Megjithatë, bizneset e regjistruara/hapura gjatë këtij viti (2024) kanë të drejtë aplikimi me kushtin që kanë qarkullim minimal prej 1,000.00€ gjatë TM1 2024.

3. Në kategorinë LOT 1 – biznes ekzistues kanë të drejtë aplikimi sektorët dhe veprimtaritë pa përjashtim (përveç tregtia, ndërtimtaria, bujqësia, shëndetësia dhe arsimit);
4. Në kategorinë LOT 2 – biznes ekzistues kanë të drejtë aplikimi vetëm bizneset që segment të veçantë e kanë prodhimin (ndalohen tregtia, ndërtimtaria, bujqësia, shëndetësia dhe arsimit).

Grantet do të ndahet në katër (4) kategori, si vijon:

1. **Start – UP** – (Studentë) i dedikohet ideve të biznesit për Start-up të cilat nuk janë ende të regjistruara si biznese;
- Projekti i aplikantëve / student duhet të jet nga fusha e studimeve të tyre.
2. **Start – UP** - i dedikohet ideve të biznesit për Start-up të cilat nuk janë ende të regjistruara si biznese;
3. **LOT 1 – Biznese ekzistuese - Ndërmarrjet mikro dhe të vogla** me një qarkullim prej 5,000.00€ deri në 50,000.00€ nga viti i fundit kalendarik, të dëshmuara nga ATK;

Megjithat, bizneset e regjistruara/hapura gjatë vitit (2024) kanë të drejtë aplikimi me kushtin që kanë qarkullim minimal prej 1,000.00€ gjatë TM1 2024, por shuma e kërkuar të jetë brenda shumave të kategorisë Start-up nga 3,000.00 € deri në 5,000.00 €;

4. **LOT 2 – Biznese ekzistuese - Ndërmarrjet mikro dhe të vogla** me një qarkullim prej 30,000.00€ deri në 300,000.00€ nga viti i fundit kalendarik, të dëshmuara nga ATK;

Ministria e Zhvillimit Rajonal si çdo vit tjetër deri më tani, edhe këtë vit me qëllim të inkurajimit dhe përkrahjes së komuniteteve jo shumicë në Kosovë, nga buxheti i kësaj Thirrje do të dedikojë 10% të këtyre mjeteve për financimin e projekteve të komuniteteve jo shumicë, ndarje kjo që nënkupton ndarjen në nivel vendi, me kusht që kjo % i plotësojnë kriteret e kësaj thirrjeje dhe i kalojnë të dy fazat e vlerësimit.

Sqarim: Sipas kategorizimit të ATK-së dhe sipas Ligjit Nr. 04/L-220 për Investime të Huaja, ndërmarrjet mikro dhe të vogla kategorizohen:

1. *Ndërmarrjet mikro prej 0-9 punëtorë;*
2. *Ndërmarrjet e vogla prej 10-49 punëtorë.*

1.5 Shumat e granteve

Çdo grant i kërkuar sipas kësaj thirrje për propozime duhet të jetë brenda shumave vijuese minimale dhe maksimale:

1. Start-up (Studentë)

Nga 2,000.00 € deri në 5,000.00 €;

2. Start-up (biznese që themelohen pas nënshkrimit të Kontratave me MZHR)

Nga 3,000.00 € deri në 5,000.00 €;

3. LOT 1 - Biznes ekzistues - Ndërmarrjet mikro dhe të vogla

Nga 5,001.00 € deri në 15,000.00 €;

4. LOT 2 - Biznes ekzistues - Ndërmarrjet mikro dhe të vogla

Nga 15,001.00 - 30,000.00 €.

Secili grant i kërkuar sipas kësaj thirrje për propozime duhet të jetë brenda përqindjeve minimale dhe maksimale të kostos totale të kualifikueshme për veprim si në vijim:

- **Për kategorinë (1) START-UP (Studentë) nuk aplikohet bashkëfinancimi;**
- **Për kategorinë (2) START-UP përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët duhet të jetë nga 5% deri në 10% kurse shuma që kërkohet nga Ministria e Zhvillimit Rajonal nuk mund të jetë nën 90% e kostos totale të projekt propozimit;**
- **Për kategorinë (3) LOT 1 - BIZNES EKZISTUES përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët duhet të jetë minimumi 10% dhe maksimumi 40% kurse shuma që kërkohet nga Ministria e Zhvillimit Rajonal nuk mund të jetë nën 60% e kostos totale të projekt propozimit;**
- **Për kategorinë (4) LOT 2 - BIZNES EKZISTUES përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët duhet të jetë minimumi 20% dhe maksimumi 49% kurse shuma që kërkohet nga Ministria e Zhvillimit Rajonal nuk mund të jetë nën 51% e kostos totale të projekt propozimit.**

Nëse gjatë realizimit të blerjeve, përfituesi arrijnë ta implementojë projektin me çmime më të vogla se sa ato të planifikuara, atëherë mund të zbritet bashkëfinancimi deri në vlerën minimale të lejuar, por nëse projekti arrijnë të implementohet edhe nën vlerën e bashkëfinancimit minimal, atëherë zbritet edhe shuma e financimit të MZHR-së, për t'u siguruar që projekti bashkëfinancohet nga përfituesi me vlerat minimale (sipas kategorive).

2 RREGULLAT PËR THIRRJEN PËR PROPOZIME

Këto udhëzime përcaktojnë rregullat për dorëzimin, përzgjedhjen dhe implementimin e projekteve të financuara sipas kësaj thirrjeje për propozime. Ekzistojnë tri grupe të kriterëve për kualifikim, që kanë të bëjnë me:

1. Aplikanti (ët) që mund të kërkojnë grant;
2. Veprimet (lloji i projektit të biznesit) për të cilin mund të jepet granti;
3. Kostoja që mund të merret në përcaktimin e shumës së grantit.

2.1 Kualifikimi i aplikantëve: kush mund të aplikojë?

Për t'u kualifikuar për grant, aplikantët duhet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jetë ndërmarrje në pronësi 100% private të regjistruar në Kosovë sipas ligjeve të Kosovës¹;
- Të jetë në gjendje të demonstrojë likuiditetin e kompanisë (apo likuiditetin potencial);
- Të regjistrohet për aktivitetet e parapara me Projekt Propozimin në kohën e aplikimit për grant (Start-Up);
- Projekt propozimi i bizneseve ekzistuese që aplikojnë për kategorinë LOT 2 Aktiviteti kryesor ose Aktiviteti sekondar i biznesit duhet të jetë prodhim;
- Të mund të demonstrojë që të gjitha kontributet dhe tatimet janë përmbushur.
- Të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e veprimeve.
- Për aplikantët Startup (Studentë) duhet të jenë në vitin e fundit të studimeve në njërin nga Universitetet publike me të cilin MZHR ka Marrëveshje Bashkëpunimi.

2.2 Aplikantët që nuk kualifikohen

Aplikantët potencialë nuk mund të përfitojnë grantin nëse gjenden në ndonjërin prej situatave që renditen si më poshtë:

- Kanë bankrotuar apo janë në mbyllje, janë nën administrim të gjykatave, kanë hyrë në marrëveshje me kreditorë, kanë pezulluar aktivitetet afariste, i janë nënshtruar procedurave në lidhje me këto çështje, ose janë në situata analoge që lindin nga procedurat e përcaktuara me legjislacionin apo rregulloret vendore;
- Klasifikimi i tyre në Regjistrin e Kredisë Kosovës (apo siç njihet në banka CRK - Credit Registry of Kosova) të llogarive Personale dhe të Biznesit është nën kategorinë B;
- Ata, apo personat që kanë autorizim përfaqësimi, vendimmarrjeje apo kontrolli mbi ta, janë dënuar për një vepër që ka të bëjë me sjelljen profesionale me aktgjykim të një autoriteti kompetent (pra kur nuk ka mundësi apelimi);
- Nuk janë në përputhje me obligimet e tyre sa i përket pagesës së kontributeve apo pagesës së tatimeve në pajtim me dispozitat ligjore të vendit në të cilin janë themeluar;
- Ata, apo personat që kanë autorizim përfaqësimi, vendimmarrjeje apo kontrolli mbi ta, kanë qenë subjekt i një aktgjykimi të prerë e të plotfuqishëm për mashtrim, korrupsion, përfshirje në organizatë kriminale, shpëlarje të parave apo ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm, ku aktiviteti i tillë i paligjshëm është dëmtues për interesat financiare të Kosovës.

2.3 Aplikantët që kualifikohen (sektorët)

Ndërmarrjet që operojnë në prodhimin dhe përpunimin e produkteve, si dhe në shërbimet komerciale janë të kualifikuara të aplikojnë. **Megjithatë luteni t'i referoheni dhe t'i**

përmbaheni në mënyrë strikte pikës 1.4 të këtij Udhëzuesi, pikave 1, 2 dhe 3.

Interes i veçantë i kushtohet projekteve që kanë mundësi të zëvendësojnë importet dhe të krijojnë eksporte që mbulojnë nevojat dhe prioritetet e mjedisit lokal.

Sektorët që **NUK KUALIFIKOHEN** në asnjë kategori të kësaj thirrjeje janë:

- Tregtia (*me pakicë dhe shumicë*);
- Ndërtimtaria (*përveç prodhimit të materialeve që përdoren në ndërtimtari - pra nuk kualifikohet ndërtimi i objekteve, blerja e mjeteve lëvizëse e të ngjashme, por kualifikohen pajisjet për prodhimin e materialeve që përdoren në ndërtimtari*);
- Bujqësia (*çdo pajisje apo aktivitet që ndërlidhet me fushë veprimtarinë e bujqësisë që financohet nga MBPZHR përjashtimit pajisjet/makineritë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve*);
- Bujqësia për LOT 2 (*çdo pajisje apo aktivitet që ndërlidhet me fushë veprimtarinë e bujqësisë që financohet nga MBPZHR në Masen 1, 3 dhe 7*);
- Shëndetësia;
- Arsimi.

2.4 Kohëzgjatja e projektit

Kohëzgjatja e planifikuar e projektit që financohet nga MZHR nuk mund të tejkalojë **6 muaj** (përveç nëse ndryshe parashihet me kushtet e kontratës).

2.5 Lokacioni i projektit

Veprimet duhet të ndërmerren brenda Rajonit Zhvillimor të prezentuar me rastin e aplikimit.

2.6 Kualifikueshmëria e shpenzimeve: kostot që mund të merren parasysh për grantin

Propozimet për financim duhet të jenë të pavarura teknikisht dhe financiarisht. Veprimet duhet të kenë ndikim të prekshëm dhe të dukshëm tek kompanitë në rritjen epunësimit, rritjen e kapaciteteve prodhuese, përmirësimin apo optimizmin e cikleve jetësore të zhvillimit të produkteve/shërbimeve dhe diversifikimin e produkteve/shërbimeve, kanalet e reja të shpërndarjes dhe shitjes në Kosovë apo tregje ndërkombëtare, zhvillimin e zinxhirit të vlerave dhe të ngjashme.

2.6.1 Kostot e kualifikueshme

Të gjitha shpenzimet duhet të jenë në përputhje me rregullat e përcaktuara me këtë thirrje. Vetëm kostot e kualifikuara mund të merren parasysh për grant.

Llojet vijuese të aktiviteteve në përputhje me synimet e programit llogariten si **shpenzime të kualifikueshme** dhe mund të financohen sipas kësaj thirrjeje për propozime:

- Investimet në asete të prekshme që kanë të bëjnë ose me blerjen e pajisjeve,

makinerisë, linjat e prodhimit, softuerë, si dhe të ngjashme apo/dhe përmirësimin e proceseve dhe metodave prodhuese si dhe duke përfshirë asetet që mund t'i ndihmojnë kompanive të jenë më pak të varura nga faktorët e jashtëm;

- Trajnimi i specializuar në lidhje me investimet e lartpërmendura si për shembull trajnime për përdorimin e pajisjeve apo teknologjisë së re (*sidoqoftë shpenzimet e trajnimeve nuk mund të kalojnë vlerën më shumë se 10% të vlerës totale të projektit*);
- Aktivitetet marketingu, si për shembull pjesëmarrja në panairë, zhvillimi i ueb faqeve, etj., për të promovuar produktet dhe shërbimet nga projekti (*sidoqoftë shpenzimet e marketingut nuk mund të kalojnë vlerën më shumë se 10% të vlerës totale të projektit*);

2.6.2 Kostot e pakualifikueshme janë:

- Borxhet dhe tarifat e mbulimit të borxhit;
- Provizionet për humbje dhe detyrime potenciale të ardhme;
- Interesat e borxhit;
- Tatimet në të hyra;
- Shpenzimet e deklaruar nga përfituesi dhe të mbuluara nga ndonjë veprim apo program tjetër pune;
- Blerja e tokës, ndërtimi apo riparimi i stabilimenteve/strukturave (përfshirë stabilimentet e depozitimit apo stabilimente/struktura të ngjashme);
- Humbjet në këmbim të valutës;
- Kreditë ndaj palëve të treta;
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- Shpenzimet e amortizimit që normalisht duhet të jenë pjesë e mënyrës në të cilën ndahen fitimet;
- Tarifat bankare, shpenzimet e garancive dhe tarifa të ngjashme;
- Kostot e artikujve apo pajisjeve të përdorura;
- Pagat dhe mëditjet;
- Shpenzimet e lëndës së parë;
- Shpenzimet e tjera operationale (qiraja, rryma, uji etj.)
- Automjetet e transportit;
- Shpenzimet e transportit;
- Inventari: tavolinat, karriget dhe dollapet, përjashtimit ato që ndërliken në mënyrë specifike me veprimtarinë.

Nëse kostot e pakualifikueshme arrijnë shumën mbi 20% të vlerës së projektit aplikacioni refuzohet. Shpenzimet e pakualifikueshme janë çështje e përfituesit, prandaj ato nuk duhet të përfshihen në kërkesën për pagesë, kështuqë përfituesi duhet të ketë mjete financiare vetanake për mbulimin e tyre.

Çdo tentim për mashtrim (për shembull: falsifikimi i faturave, manipulimi i procedurave të prokurimit, blerja e makinave apo pajisjeve të përdorura, etj.) do të ndëshkohet me mos pagesë të asaj pjese që është subjekt i mashtrimit dhe ndëshkime shtesë deri në

përrjashtim total nga pagesa, siç parashihet me sistemin ndëshkimor që është pjesë e kontratës.

Është në interesin e aplikantit të paraqesë buxhet realist dhe efektiv për koston, gjithsesi Komisioni vlerësues i MZHR-së ka kompetenca të trajtoj dhe të hulumtojë tregun e çmimeve lidhur me çmimet e paraqitura në ofertë/a dhe buxhet në rastet kur e vlerëson se çmimet nuk janë realiste.

Komisioni vlerësues ka të drejtë të marrë sqarime nga Dogana e Kosovës, ATK dhe inspektorati i tregut në rast se dyshon për çmime jo reale. Në rast se Komisioni konstaton se çmimet e ofruara në ofertë/a dhe buxhet nuk janë realiste, mundet që aplikacionin ta diskualifikojë për mungesë korrektesie.

2.7 Procedurat e Prokurimit

Procedurat e Prokurimit do të jenë pjesë e kontratës së nënshkruar në mes të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe përfituesit.

3 SI TË APLIKOHET DHE PROCEDURAT QË DUHET NDJEKUR

3.1 Mënyra e aplikimit

Aplikantët ftohen që të plotësojnë formularin e aplikimit duke përdorur formularin e aplikimit të dizajnuar nga autoriteti kontraktues përmes platformës [eKosova](#) **Aplikantët duhet t'i përmbahen strikt formateve të aplikimit dhe të plotësojnë paragrafët dhe faqet me rend.**

Pako e Aplikimit, në bazë të natyrës së biznesit aplikues ndahet në:

1. Pako aplikimi për Start-UP (Studntë), dokumentet që duhet të plotësohen dhe të uploadohen/ngarkohen në platformën [eKosova](#) janë:
 - **Shtojca A1: Formulari i aplikimit;**
 - **Shtojca B1: Buxheti,**
 - **Shtojca B2: Projeksioni financiar;**
 - **Shtojca C1: Deklarata e aplikantit/Studentit** që merret edhe si deklaratë nën betim përvërtetësinë e dokumentacionit e cila pasi të plotësohet nga aplikanti duhet të konvertohet në PDF;
 - **Shtojca D1: Plani i veprimit;**
 - **Dëshmia mbi fushën e studimeve dhe që është studentë i vitit të fundit të studimeve;**
 - **Oferta për makinerinë apo pajisjet/shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit** - oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofertuesit dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës poashtu duhet të ketë edhe emërtimin dhe specifikimin teknik të saktë të pajisjes/shërbimit dhe nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së thirrjes për propozime. Ofertat e marrura brenda vendit, duhet të jenë të nënshkruara dhe të vulosura nga ofertuesi, këto Ofertat duhet të jenë vetëm në valutën EURO,

Vërejtje: Dokumentet e listuara më lartë duhet të jenë me dukshmëri të qartë rekomandohet të jenë në formatin PDF.

2. Pako aplikimi për Start-UP, dokumentet që duhet të plotësohen dhe të uploadohen/ngarkohen në platformën [eKosova](#) janë:
- **Shtojca A2: Formulari i aplikimit;**
 - **Shtojca B1: Buxheti dhe Burimet e financimit;**
 - **Shtojca B2: Projektioni financiar;**
 - **Shtojca C1: Deklarata e aplikantit** që merret edhe si deklaratë nën betim përvërtetësinë e dokumentacionit e cila pasi të plotësohet nga aplikanti duhet të konvertohet në PDF;
 - **Shtojca D1: Plani i veprimit;**
 - **Oferta për makinerinë apo pajisjet/shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit** - oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofertuesit dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës po ashtu duhet të ketë edhe emërtimin dhe specifikimin teknik të saktë të pajisjes/shërbimit dhe nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së thirrjes për propozime. Ofertat e marrura brenda vendit, duhet të jenë të nënshkruara dhe të vulosura nga ofertuesi, këto Oferta duhet të jenë vetëm në valutën EURO).

Vërejtje: Dokumentet e listuar më lartë duhet të jenë me dukshmëri të qartë rekomandohet të jenë në formatin PDF.

3. Pako aplikimi për LOT 1 - biznes ekzistues, dokumentet që duhet të plotësohen dhe të uploadohen/ngarkohen në platformën [eKosova](#) janë:
- **Shtojca A3: Formulari i aplikimit;**
 - **Shtojca B1: Buxheti dhe Burimet e financimit;**
 - **Shtojca B2: Projektioni financiar;**
 - **Shtojca C1: Deklarata e aplikantit** që merret edhe si deklaratë nën betim përvërtetësinë e dokumentacionit e cila pasi të plotësohet nga aplikanti duhet të konvertohet në PDF;
 - **Shtojca D1: Plani i veprimit;**
 - **Oferta për makinerinë apo pajisjet/shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit** – oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofertuesit dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës po ashtu edhe emërtimin dhe specifikimin teknik të saktë të pajisjes dhe nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së thirrjes për propozime. Ofertat e marrura brenda vendit, duhet të jenë të nënshkruara dhe të vulosura nga ofertuesi (Ofertat duhet të jenë vetëm në valutën EURO);
 - **Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha fletët/informatat përcjellëse** sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, e cila duhet të jetë e lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues. Kompania duhet ta ketë të regjistruar si aktivitet primar ose sekondar aktivitetin me të cilin aplikon me projekt.
 - **Vërtetimi tatimor me validitet në ditën e aplikimit (jo më i vjetër se 90 ditë)** me të cilin vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime të tjera tatimore, ose është në marrëveshje për

- shlyerjen e borxhit me ATK (mund të nxjerrët online nga ueb faqja e ATK-së);
- **Lista e punëtorëve për vitin e fundit fiskal (2023) të lëshuar nga ATK** (mund të nxjerrët online nga ueb faqja e ATK-së);
- **Deklarata tatimore vjetore për vitin e fundit fiskal (2023) të lëshuar nga ATK** (të ardhurat bruto të dëshmohen nga Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2023);
- **Foto të objektit ekzistues të biznesit si dhe pajisjeve ekzistuese** (fotot duhettë jenë të dukshme qartë).
- **Ofertat preferohet të jenë në valutën EURO, megjithatë në rastet kur oferta është në valutën e Dollarit Amerikan aplikuesi duhet të bashkëngjisë edhe dëshminë e kalkulimit (kursin valutor) të datës së marrjes së ofertës.**

Vërejtje: Dokumentet e listuara më lartë duhet të jenë me dukshmëri të qartë rekomandohet të jenë në formatin PDF, kurse fotot mund të jenë në JPG dhe si të tilla upload-ohet / ngarkohet në sistem me rastin e aplikimit

4. Pako aplikimi për LOT 2 - biznes ekzistues, dokumentet që duhet të plotësohen dhe të upload-ohen/ngarkohen në platformën [eKosova](#) janë:
 - **Shtojca A4: Formulari i aplikimit;**
 - **Shtojca B1: Buxheti dhe Burimet e financimit;**
 - **Shtojca B2: Projektioni financiar;**
 - **Shtojca C1: Deklarata e aplikantit** që merret edhe si deklaratë nën betim përvërtetësinë e dokumentacionit e cila pasi të plotësohet nga aplikanti duhettë konvertohet në PDF;
 - **Shtojca D1: Plani i veprimit;**
 - **Oferta për makinerinë apo pajisjet/shërbimet e planifikuara në projekt për vlerën totale të projektit** – oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofertuesit dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës poashtu edhe emërtimin dhe specifikimin teknik të saktë të pajisjes dhe nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së thirrjes për propozime. Ofertat e marrura brenda vendit, duhet të jenë të nënshkruara dhe të vulosura nga ofertuesi (Ofertat duhet të jenë vetëm në valutën EURO);
 - **Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha fletët/informatat përcjellëse** sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, e cila duhet të jetë e lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues. Kompania duhet ta ketë të regjistruar si aktivitet primar ose sekondar aktivitetin me të cilin aplikon me projekt.
 - **Vërtetimi tatimor me validitet në ditën e aplikimit (jo më i vjetër se 90 ditë)** me të cilin vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime të tjera tatimore, ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK (mund të nxjerrët online nga ueb faqja e ATK-së);
 - **Lista e punëtorëve për vitin e fundit fiskal (2023) të lëshuar nga ATK** (mund të nxjerrët online nga ueb faqja e ATK-së);
 - **Deklarata tatimore vjetore për vitin e fundit fiskal (2023) të lëshuar nga**

ATK (të ardhurat bruto të dëshmohe nga Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2023);

- **Foto të objektit ekzistues të biznesit si dhe pajisjeve ekzistuese** (fotot duhet të jenë të dukshme qartë).
- **Ofertat preferohet të jenë vetëm në valutën EURO, megjithatë në rastet kur oferta është në valutën e Dollarit Amerikan aplikuesi duhet të bashkëngjisë edhe dëshminë e kalkulimit (kursin valutor) të datës së marrjes së ofertës.**

Vërejtje: Dokumentet e listuara më lartë duhet të jenë me dukshmëri të qartë rekomandohet të jenë në formatin PDF, kurse fotot mund të jenë në JPG dhe si të tilla upload-ohet / ngarkohet në sistem me rastin e aplikimit.

Aplikacionet mund të plotësohen në gjuhën Shqipe apo Serbe dhe të dërgohen p e r m e s platformës [eKosova](#)

Aplikacionet fizike apo të shkruara me dorë nuk do të pranohen.

Vetëm formularët e PLOTËSUAR të aplikimit dhe Shtojcat do të kalojnë për vlerësim. Prandaj këto dokumente duhet të përmbajnë TË GJITHA informatat relevante në lidhje me veprimin.

Vlerësimi i aplikacioneve do të përfshijë një **kontroll administrativ** për t'u siguruar që aplikantët kanë plotësuar kriteret e kualifikimit. Procesi i **vlerësimit përmbajtjesor** do të konsiderojë nëse aplikacioni demonstroi që ndërmarrja ka perspektivë të mirë të të qenit e suksesshme dhe e qëndrueshme, si dhe që implementimi do të kontribuojë drejt përmbushjes së synimeve të Skemës së Granteve për të ndihmuar zhvillimin ekonomik të Kosovës. Grantet do t'u jepen aplikantëve me më shumë poena sipas renditjes në secilën kategori, deri në kufijtë e buxhetit në dispozicion.

Në rastet kur ka mos përputhje të vlerave buxhetore në projekt, konfuzitet në përshkrim të projektit dhe gabim në përdorimin e formateve të përcaktuara në thirrjen për propozime, projekti do të diskualifikohet.

MZHR nuk është përgjegjëse për koston që ndërlihet me përgatitjen e aplikacionit.

Përfituesit (pronarët e bizneseve që kanë përfituar grant) nga skemat **Programi për Zhvillim Rajonal të Blancuar (PZHRB) 2022, Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) 2023**, nuk kanë të drejtë aplikimi për këtë thirrje si dhe ata që kanë dështuar në implementimin e projekteve nga këto skema.

3.2 Ku dhe si të bëhet aplikimi

Aplikimi bëhet online përmes platformës [eKosova](#)

[Rajonet Zhvillimore përfshijnë Komunitat në vijim:](#)

- Për rajonin zhvillimor **(01)** veprimtaritë e bizneseve që veprojnë në komunitat (Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Lipjan, Glogoc, Graçanicë).

- Për rajonin zhvillimor **(02)** veprimtaritë e bizneseve që veprojnë në komunat (Mitrovica e Jugut, Skenderaj, Vushtrri, Zveqan, Leposaviq, Zubin Potok, Mitrovica Veriore).
- Për rajonin zhvillimor **(03)** veprimtaritë e bizneseve që veprojnë në komunat (Pejë, Istog, Klinë, Deçan).
- Për rajonin zhvillimor **(04)** veprimtaritë e bizneseve që veprojnë në komunat (Prizren, Suharekë, Dragash, Mamushë).
- Për rajonin zhvillimor **(05)** veprimtaritë e bizneseve që veprojnë në komunat (Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shterpcë, Hani i Elezit).
- Për rajonin zhvillimor **(06)** veprimtaritë e bizneseve që veprojnë në komunat (Gjilan, Kamenicë, Viti, Novobërda, Partesh, Ranillukë, Kllokot).
- Për rajonin zhvillimor **(07)** veprimtaritë e bizneseve që veprojnë në komunat (Gjakovë, Rahovec, Malishevë, Junik)

Për Start-Up aplikimi duhet të bëhet nga personat të cilët synojnë të fillojnë biznesin dhe jo nga persona të tjerë në emër të tyre.

Për LOT 1 dhe LOT 2 (biznese ekzistuese) aplikimi duhet të bëhet nga pronarët/aksionarët e bizneseve siç figurojnë në certifikatën e ARBK-së apo të autorizuarit e tyre me autorizim të noterizuar, autorizim ky që duhet upload-ohet / ngarkohet në sistem me rastin e aplikimit.

Sqarim: Një aplikant nuk mund të dorëzojë më shumë se një aplikacion në këtë Thirrje për Propozime.

3.3 Informata të mëtutjeshme për aplikimin

Pas lansimit të thirrjes dhe publikimit të udhëzuesit, sesionet informuese lidhur me këtë thirrje për të gjithë aplikantët e interesuar i organizon Ministria e Zhvillimit Rajonal .

Ministria e Zhvillimit Rajonal do të organizoj sesione informuese për të shtatë (7) Rajonet Zhvillimore si dhe do të caktojë zyrtarë përgjegjës për dhënien e informacioneve/këshillave për palët e interesuara (brenda objektit Qeveritar ish objekti i Rilindjes, kati përdhese brenda orarit zyrtar të punës 08:00-16:00).

Megjithatë, mund të dërgohen pyetje shtesë në email-in: Hashim.Ibishi@rks-gov.net më së voni deri më **27/05/2024** në ora **16:00**.

Me rastin e parashtrimit të pyetjeve ato duhet të jenë të qarta e të detajuara si dhe duhet specifikuar qartë pyetjen për thirrjen për propozime si dhe kategorinë të cilës i referohet.

MZHR nuk ka për obligim të ofrojë qartësime të mëtutjeshme ndaj pyetjeve që dorëzohen pas datës **27/05/2024**.

3.4 Afati i fundit për aplikim

Afati i fundit për aplikim është 05.06.2024 ora 16:00 platformës [eKosova](#)
Pas këtij afati aplikacionet nuk pranohen.

Aplikacionet fizike apo me postë nuk pranohen.

4 KRITERET E VLERËSIMIT

Për të kaluar fazën e vlerësimit përmbajtjesor, projekt propozimi duhet të arrijë së paku 50 pikë. Pas vlerësimit, aplikantët do të renditen sipas pikëve të fituara. Aplikimet me pikët më të larta do të përzgjidhen si përfitues deri në shpenzimin e buxhetit në dispozicion kurse pas shpenzimit të buxhetit, pjesa tjetër e aplikuesve që kanë arritur së paku 50 pikë mbeten në listën e pritjes/rezervë dhe renditja e listës rezervë do të jetë nga aplikantët me më së shumti pikë deri tek ata me më pak pikë të fituara.

Lista rezervë mbyllet në përfundim të vitit fiskal 2024, pra nuk vlen në vitin 2025.

Pjesa / Elementet e notimit	Vlera e përgjithshme/Pikët maksimale	
	START-UP	LOT 1 & 2
1. Kapaciteti financiar dhe operacional	20	30
2. Relevanca e veprimit	25	20
3. Efektshmëria dhe arritshmëria	25	15
4. Qëndrueshmëria e veprimit	15	20
5. Buxheti dhe efektshmëria në kosto	15	15
GJITHSEJ PIKË (MAKSIMUM)	100	100

5 ANKESAT

Pas publikimit të rezultateve, aplikantët mund të adresojnë ankesat e tyre përmes platformës [eKosova](#)